



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 8, datë 28.01.2021

**PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS MODEL PËR KALIMIN E MASËS SË GRANTIT TË
RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I
DATËS 26 NËNTOR 2019 SIPAS PROJEKTEVE MODEL NGA BASHKIA DURRËS
TEK PËRFITUESI**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinarë dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e kontratës model “Për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi”, bashkëngjitur.
2. Miratimin e masës së grantit të rindërtimit të shtëpive individuale për objektet, të cilat janë klasifikuar për prishje, sipas akt ekspertizave të thelluara të mbajtura nga Instituti i Ndërtimi Tiranë, që duhen rindërtuar sipas preventivave projekt model, si më poshtë:

- 2,236,552 (dy milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, për familjet me përbërje familjare deri në 2 (dy) anëtarë, me sip.70 m² dhe strukturë 1+1.
 - 2,617,558 (dy milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë, për familjet me përbërje familjare deri në 4 (katër) anëtarë, me sip.80 m² dhe strukturë 2+1.
 - 3,428,958 (tre milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, për familjet me përbërje familjare deri në 5 (pesë) anëtarë, me sipërfaqe jo më pak se 90 m² dhe strukturë 3+1.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinarë dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.01.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____ . ____ .202_

KONTRATË (MODEL)

PËR KALIMIN E MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT PËR SHTËPI INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTEVE MODEL, NGA BASHKIA DURRËS TEK PËRFITUESI

Kjo Kontratë Granti, nënshkruhet sot më datë __/__/202_ “Data e Nënshkrimit” ndërmjet palëve të mëposhtme:

Bashkia Durrës me numër identifikimi (NIPT) K42006501R, me adresë : Lagjja nr.1, Sheshi “Liria”, Durrës, përfaqësuar nga zëvendëskryetar znj.Emiriana Sako.

Dhe

Z/Zj. _____, atësia _____, i/e datë lindjes _____, lindur në _____ dhe banuese në Tiranë, mbajtës i dokumentit të identifikimit ID me numër personal _____, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim referuar si “Përfituesi”.

Bashkia Durrës dhe Përfituesi do të quhen në vijim individualisht si “Pala” dhe së bashku “Palët”.

Duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake:

- A. Në kuadër të programit të rindërtimit të banesave, Bashkia Durrës në zbatim të funksioneve publike dhe kompetencave të saj, me qëllim mbështetjen dhe garantimin e kthimit në kushte optimale jetese të komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, si dhe forcimin e aftësisë së këtyre komuniteteve për t’i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në kohë sa më të afërt, në respektim të legjislacionit të zbatueshëm ka ndjekur procedurat përzgjedhëse dhe aprovuar lëvrimin e grantit të rindërtimit sipas kushteve të kësaj Kontrate;
- B. Përfituesi ka vendbanimin në territorin e njësisë administrative të Bashkisë Durrës, i cili gjatë

- fatkeqësisë natyrore të datës 26.11.2019, në bazë të Aktekspertizës së thelluar të Insitutit të Ndërtimit ka pësuar dëmtim të banesës 1+1 / 2+1 / 3+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur kësaj kontratë (“Banesa/Shtëpia individuale”) dhe është klasifikuar si objekt i cili duhet të prishet;
- C. Përfituesi i dëmtuar ka deklaruar nën përgjegjësinë e tij personale se nuk ka përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit;
- D. Përfituesi ka paraqitur kërkesë pranë Njesisë Administrative aplikimin nr.____, datë ___/___/___ regjistruar me nr. _____ prot, në regjistrin elektronik të të dhënave, për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rindërtimit. Në bazë të shkallës së dëmtimeve të pasqyruara në akt ekspertizen e thelluar , aplikimi i përfituesit është klasifikuar si objekt i cili duhet të prishet;
- E. Njësitë Administrative përcjellin aplikimin pranë strukturave të posaçme të Bashkisë Durrës , ku pas verifikimeve të kryera nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin është vlerësuar si subjekt përfitues, me vendimin nr. _____, datë ___/___/___ të Këshillit Bashkiak dhe shuma e grantit për rindërtimin e shtëpisë individuale për Përfituesin është miratuar të jetë _____ (_____) lekë.

Atëherë, duke marrë në konsideratë kushtet paraprake, palët bien dakord të lidhin këtë Kontratë Granti “**Kontrata**”, sipas kushteve dhe termave si më poshtë:

Neni 1 Baza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, i ndryshuar, Vendimi nr. 904, datë 24.12.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”,

Për çdo gjë tjetër tej kontratës, palët do t’i referohen dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 2
Objekti dhe qëllimi i kontratës

- 2.1** Objekti i kësaj kontrate është lëvrimi i shumës së grantit të rindërtimit të shtëpise individuale në masën prej _____ (_____) lekë nga Bashkia Durrës, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr._____, datë _____._____._____, në favor të Përfituesit në kuadër të VKM-në nr. 879, datë 11.11.2020 Për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 6.1.2020, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, sipas parashikimeve në Nenin 3.
- 2.2** Përfituesi do të përdorë shumën për rindërtimin e shtëpive individuale të lëvruar nga Bashkia Durrës vetëm për qëllimin e përcaktuar në pikën 2.1 më sipër, në përputhje me kushtet dhe termat e përcaktuara në këtë Kontratë.

Neni 3
Plotësimi i kushteve dhe Lëvrimi i Grantit

- 3.1** Shuma e grantit për rindërtimin e shtëpise individuale sipas nenit 2, pika 2.1, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr._____, datë _____._____._____, do të lëvrohet nga Bashkia e Durrës me dy këste në këtë mënyrë:
- 3.1.1** Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, Bashkia Durrës do të kalojë në llogarinë bankare të përfituesit , 60% (gjashtëdhjetë pwrqind) të shumës së grantit të rindërtimit të shtëpise individuale, përkatësisht në vlerën prej _____ (_____) lekë (“Kësti i parë i shumës së grantit të rindërtimit të shtëpise individuale”). Tërheqja e kështit të parë të shumës së grantit të rindërtimit nga subjekti përfitues do të kryhet në momentin e lëshimit të aktit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- 3.1.2** Subjekti Përfitues i grantit duhet të dorëzojë projektin model, që kërkohet të financohen për rindërtimin e shtëpise individuale, të hartuar nga projektues të licencuar si edhe dokumentacionin e plotë tekniko ligjorë të konfirmuar nga struktura përgjegjëse e Bashkisë Durrës mbi rregullsinë dhe ligjshmërinë e tyre.
- 3.1.3** Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga verifikimi prej strukturës përkatëse, e cila shqyrton kërkesën për lejen ndërtimore, konfirmon ligjshmërinë e dokumentacionit të plotë tekniko ligjorë të projektit model dhe mbikqyr zbatimin e kësaj kontrate, se subjekti përfitues ka ekzekutuar kushtet e kësaj kontrate, Bashkia Durrës do të kalojë në llogarinë bankare të përfituesit, diferencën e mbetur nga shuma e grantit të rindërtimit (Kësti i dytë i shumës së grantit të rindërtimit të shtëpise individuale’).
Në asnjë rast shuma e grantit të rindërtimit të shtëpise individuale sipas projektit model nuk mund të jetë më e lartë se shuma maksimale e miratuar me vendimin nr. _____, datë ____ / ____ / ____ të Këshillit Bashkiak.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

4.1 Përfituesi merr përsipër dhe deklaron:

- (a) Të përdorë vlerën e grantit të rindërtimit ekskluzivisht dhe vetëm me qëllimin e specifikuar në nenin 2 të kësaj kontrate dhe të respektojë afatet e përcaktuara në lejet përkatëse të ndërtimit, për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të nevojshme;
- (b) Të ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm për t'u pajisur me lejet dhe autorizimet përkatëse për rindërtimin, sipas parashikimeve të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pas nënshkrimit të kësaj kontrate;
- (c) Përfituesi nuk mund të përfitojë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin e zbatueshëm;
- (d) Në rast se shuma e grantit të rindërtimit lëvruar nga Bashkia Durrës do të përdoret për qëllime të ndryshme nga objekti i kësaj Kontrate, atëherë Përfituesi do i nënshtrohet sanksioneve sipas parashikimeve në pikën 5.3 më poshtë si dhe nuk do të ketë të drejtë të përfitojë nga programet e tjera të rindërtimit dhe/ose sociale pranë Bashkisë Durrës.
- (e) Nuk është subjekt përfitues ai që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;
- (f) Nuk është subjekt përfitues si subjekt i së drejtës tregtare në fushën e ndërtimit për ndërtesat ose njësitë brenda një ndërtese në pronësi të tij, që janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, kur dëmi ka ardhur si rrjedhojë e gabimeve në projektimin apo ndërtimin e ndërtesës kryer prej vetë subjektit ndërtues që është njëkohësisht dhe pronar i objektit, përveç rastit kur zbatohet zhvillimi i detyruar vendor sipas parashikimeve të këtij akti;
- (g) Përfituesi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate ka detyrimin që të depozitojë pranë Bashkisë Durrës projektin për rindërtimin e shtëpisë individuale si dhe dokumentacionin e plotë tekniko ligjorë për rindërtimin e shtëpisë individuale të prishur;
- (h) Përfituesi deklaron dhe garanton Bashkinë Durrës se pranon kushtet e kësaj Kontrate granti për rindërtimin e shtëpisë individuale sipas projektit model të miratuar nga autoriteti përgjegjës;

4.2 Bashkia Durrës merr përsipër:

- (a) Të sigurojë grantin e rindërtimit për Përfituesin në vlerën e përcaktuar në objektin e kësaj kontrate dhe të disbursojë atë sipas afateve dhe kushteve të rëna dakord në këtë Kontratë;
- (b) Mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës prej përfituesit nga struktura përgjegjëse e caktuar me urdhër të kryetarit të Bashkisë Durrës, e cila në rast shkeljesh, do i propozojë kryetarit të

Bashkisë Durrës aplikimin e penaliteteve, sipas parashikimeve të kësaj kontrate;

(c) Lehtësimin për aq sa është e mundur, të procedurave për dhënien e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për rindërtimin e shtëpisë individuale së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, sipas lehtësirave të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm;

(d) Të bashkërendojë punën me Njësinë Administrative _____ ku ndodhet ndërtesa që do të rindërtohet, në funksion të realizimit të procesit të rindërtimit dhe të zbatimit të kësaj kontrate granti;

(e) Të përjashtojë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifat e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit për rindërtimin e shtëpisë individuale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

(f) Të kryejë procedurat përkatëse për disbursimin në favor të përfituesit të vlerës së grantit , pas plotësimit të kushtit nga përfituesi i grantit për dorëzimin e projektit model dhe dokumentacionin tekniko ligjore për rindërtimin e shtëpisë individuale të dëmtuar.

Neni 5

Sanksionet

5.1 Përfituesi do t'i përgjigjet Bashkisë Durrës për çdo dëm që vjen nga shkelja e ndonjë prej detyrimeve ligjore ose kontraktuale nga Përfituesi.

5.2 Përfituesi në rast deklarimeve të rrema dhe përfitimi në mënyrë të padrejtë të grantit të rindërtimit, detyrohet të kthejë pas të gjithë shumën e përfituar dhe të rimbursojë Bashkinë Durrës për çdo dëm të shkaktuar.

5.3 Në rast se Përfituesi përdor fondet e dhëna ose pjesë të tyre në një mënyrë që nuk përputhet me këtë kontratë dhe në rast se ai nuk respekton afatet e parashikuara në lejet dhe autorizimet përkatëse të ndërtimit, Bashkia Durrës ka të drejtë të kërkojë nga Përfituesi kthimin e grantit të përdorur në mënyrë të padrejtë si dhe të zbatojë penaltetet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për këto kontrata.

Neni 6

Mospërmbushja dhe Zgjidhja e njëanshme e kontratës

6.1 Ngjarjet në vijim do të përbëjnë ngjarje të mospërmbushjes nga Përfituesi:

(a) Përfituesi nuk e përdor grantin e përfituar nga Bashkia Durrës për qëllimin e përcaktuar në pikën 2.1 më sipër.

(b) Përfituesi nuk depoziton brënda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate pranë Bashkisë Durrës projektin model dhe dokumentacionin tekniko ligjore për rindërtimin e shtëpisë individuale të dëmtuar.

6.2 Pasojat e Mospërmbushjes:

Në rast se, Përfituesi do të ndodhet përpara njërit prej parashikimeve të mospërbushjes si më lart, atëherë Bashkia e Durrës ka të drejtë:

- (i) Të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kësaj kontrate, si dhe të kërkojë kthimin e plotë të shumës së lëvruar dhe dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar (nëse ka).
- (j) Përfituesi i grantit ka detyrimin e kthimit të plotë të shumës që ka përfituar dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar (nëse ka).

Neni 7

Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj aktmarrëveshje, palët paraprakisht duhet të diskutojnë për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët do i drejtohen Gjykatës kompetente.

Neni 8

Të ndryshme

8.1 Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi në Datën e Nënshkrimit nga Palët dhe përbën marrëveshjen e plotë mes palëve.

8.2 Pjesë e kësaj kontrate është dhe deklarata që përfituesit deklarohet dhe nënshkruan nën përgjegjësinë e tij se të dhënat e aplikimit dhe çdo e dhënë tjetër, janë të vërteta dhe në rast deklarimi të të dhënave të rreme, duhet të kthej pas vlerën e grantit të përfituar si dhe dëmshpërblimin e çdo dëmi tjetër të shkaktuar Bashkisë Durrës.

8.3 Kontrata përpilohet në 3 (tre) kopje, me vlerë dhe përmbajtje të njëjtë juridike, nga të cilat 2 (dy) kopje i mban bashkia dhe 1 (një) kopje e mban përfituesi i grantit.

8.4 Kontrata nënshkruhet në çdo fletë nga të dyja palët kontraktore

Neni 9

Dispozitat e fundit

Ngarkohet Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Njësia Administrative, Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Durrës, dhe përfituesi i grantit për zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë kontratë.

Neni 10
Dokumentacioni bashkëlidhur kontratës

Kësaj kontrate si pjesë përbërëse e saj, i bashkëlidhen edhe dokumentet e mëposhtme:

1. Karta e identitetit të Perfituesit.
2. Planimetria e banesës/shtepise individuale së përfituesit .
3. Të dhënat e llogarisë bankare te perfituesit pranë një banke të nivelit të dytë.

Kjo kontratë, pasi u lexua dhe kuptua, u nënshkrua rregullisht nga palët si më poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE:

PALA E PARË
BASHKIA DURRËS
ZËVENDËSKRYETAR

Emiriana Sako

PALË E DYTË
PËRFITUESI I GRANTIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 89/prot.
8

Durrës, më 01/02 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 8 datë 28.01.2021 “Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

